

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj, anëtarë në çështjen juridike të paditësit ECO “Higjiena” sh.p.k., me seli në Gjilan, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit B.O. nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit V.H., duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Ekonomike III.C.nr.293/2013, i datës 24.05.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.03.2018, mori këtë :

A K T G J Y K I M

REFUZOHET, si e pabazuar ankesa e paditësit ECO “Higjiena” sh.p.k., me seli në Gjilan, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr.293/2013, i datës 24.05.2016, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit ECO “Higjiena” sh.p.k., me seli në Gjilan, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”, me seli në Prishtinë, për shkak të përmbushjes së detyrimit sipas policës së sigurimit në shumën e përgjithshme prej 7,520.00 €, me kamatë ligjore prej 7.5%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë 11.06.2013, e deri në pagesën definitive të borxhit kryesor dhe është vendosur që shpenzimet procedurale t’i bartë secila palë veç e veç.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike , zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta miratoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e atakuar ta anuloj, ashtu që çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pretendimet nga përgjigja në ankesë, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ECO “Higjiena” sh.p.k., me seli në Gjilan, ka paraqitur padi me datë 11.06.2013, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”, me seli në Prishtinë dhe kërkuar që të obligohet e paditura që në emër të përmbushjes së detyrimit sipas policës së sigurimit, paditësit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 7,520.00 €, me

kamatë ligjore prej 7.5 %, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, me arsyetim se te punët e kontraktuara dhe të përfunduara janë paraqitur të meta të fshehura pas pranimit të punëve.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, ka gjetur se nuk ishte kontestuese se paditësi ka lidhur kontratë me NNT “Euro Toni”, për rregullimin e oborrit të objektit të ri KRM “Higjiena” sh.a. me seli në Gjilan. E paditura Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”, ka lëshuar policën për sigurim me nr.59157, të datës 11.06.2013, për NNT “Euro Toni”, ku e paditura në cilësi të garantuesit, do të paguaj paditësit shumën prej 7,520.00 €, në rast se do të pësonte dëm, nëse NNT “Euro Toni”, nuk do i përmbushte detyrimet sipas kontratës nr.430. Për gjykatën e shkallës së parë ishte kontestuese çështja se e paditura a kishte obligimin e përmbushjes së detyrimit sipas policës. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, duke u bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të ndërtimtarisë Sh.Q., e paditura Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”, nuk ka ndonjë obligim kontraktues ndaj paditësit ECO “Higjiena” sh.p.k., me seli në Gjilan. Prandaj gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se nuk ekziston obligimi i të paditurës si dhënëse e garancionit, pasi që NNT “Euro Toni”, i ka përmbushur në tërësi punët e parapara sipas kushteve të kontratës, andaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e paditësit lidhur me gjendjen faktike, se gjykata e shkallës së parë ka injoruar provat e dorëzuara nga paditësi në lidhje me vërtetimin e gjendjes faktike dhe i fali besimin vetëm ekspertizës, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë nga shkresat e lëndës dhe provat e administruara kishte gjetur se për pranimin e punimeve të realizuara nga NNT “Euro Toni”, ishte formuar një komision për pranimin teknik të punimeve, e po ashtu edhe ishte bërë pranimi teknik i punimeve të kontraktuara, prej nga ka rezultuar se kontraktuesi NNT “Euro Toni”, i ka përmbushur obligimit kontraktuale ndaj punëdhënësit – paditësit, poashtu nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit të ndërtimtarisë Sh.Q., është vërtetuar se e paditura nuk ka ndonjë obligim kontraktues ndaj paditësit ECO “Higjiena” sh.p.k., me seli në Gjilan. Eksperti në sqarimet e dhëna në seancën e datës 09.12.2015, ka shpjeguar se në aspektin teknik, konform ligjit për ndërtim (Nr.04/L-110), kur komisioni për pranim teknik bënë pranimin e punëve pa vërjetje, punët konsiderohen të përfunduara. Nga Raporti i Komisionit për pranim teknik të punëve, të paditëses rezulton se punët janë pranuar pa asnjë vërejtje dhe është konstatuar se punët janë kryer në përputhje me paramasën dhe parallogaritë e kontraktuara me tender. Madje Komisioni ka konstatuar se punimet e kryera i

plotësojnë standardet teknike dhe këtë konstatim komisioni e ka dhënë duke u bazuar në mostrat e shqyrtuara për materialet e përdorura. Prandaj kjo gjykatë vlerëson ka qenë obligim i komisionit të bëjë vlerësim e detajuar dhe të drejtë të punëve të përfunduara, në momentin e pranimit pasi në momentin e pranimit të punëve përfundojnë obligimet kontraktuese ndërsa dëmet eventuale mund të paraqiten edhe nga faktorët e jashtëm që nuk ndërliken domosdoshmërisht me kualitetin e dobët të punimeve.

Gjykata e Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë, drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, saktësisht nenin 897 të LMD-së sipas të cilit përcaktohet: *"Me kontratën mbi sigurimin obligohet kontraktuesi i sigurimit që mbi parimet e reciprocitetit e të solidaritetit të bashkojë një shumë të caktuar në bashkësinë e sigurimeve respektivisht në bashkësinë e rrezikut (siguruesi) kurse bashkësia obligohet që nëse ndodhë ngjarja që paraqet rastin e siguruar, t'i paguajë siguruesit apo ndonjë personit të tretë kompensimin, respektivisht shumën e kontraktuar që të kryejë diçka tjetër"*. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se operatori ekonomik NNT "Euro Toni", i ka kryer të gjitha punët si ishin përcaktuar me kontratë, prej nga rrjedh se i padituri nuk mund të ketë ndonjë obligim ndaj paditësit pasi që nuk ka ndodhur rasti i siguruar, ndërsa polisa për sigurimin e ekzekutimit të kontratës hyn në fuqi vetëm në rast kur operatori ekonomik nuk i kryen punimet e kontraktuara.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi pretendimet tjera të paditësit në lidhje me refuzimin e propozimit për caktimin e eksperti tjetër të ndërtimitarisë nga gjykata e shkallës së parë, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara, sepse bazuar në nenin 356 të LPK-së, i cili përcakton se: *"Gjykata, me propozimin e palëve mund të bëjë të provuarit me anë të ekspertizës, sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijëni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes"*. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar në mënyrë të drejtë se nuk ishte e nevojshme nxjerrja e një ekspertize të re pasi që të gjitha faktet dhe rrethanat vendimtare ishin të qarta dhe të provuara me provat që gjinden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,
Ae.nr.199/2016,dt.13.03.2018

KRYETARI I KOLEGJIT,
MahirTutuli,d.v.